



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), nenit 5.2 të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008) dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrje Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, nenit 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr. 06 -103/1 të datës 11.09.2008, në mbledhjen e mbajtur më 10.03.2022 Kuvendi i Komunës miraton këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

Neni I

Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Dragashit për Ndërmarrjen Publike Lokale, "Eko-Regjioni" Sh.A, me këtë përbërje:

1. Mehmet Spahiu - i emëruar nga Kuvendi Komunës anëtar,
2. Naser Myrtezani - i emëruar nga Kuvendi Komunës anëtar,
3. Veton Halili - i emëruar nga Kryetari Komunës anëtar.

Neni II

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008" dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012" i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009 dhe me Ligjin Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/2018" dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

Neni III

1. Mandati i anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Dragash.
2. Kuvendi i Komunës në Dragash, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni IV

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Dragash, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

I dërgohet:

- MAPL-së (zyra ligjore) – Prishtinë;
- Eko- Regionit – Prizren;
- Arkivit;

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01Nr. 060/01-3947/22/3

Dt. 10.03.2022

KRYESUESI I KUVENDIT

Uran Halimi

